MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË PUNËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ***Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP Tiranë,*** me objekt: "*Vlerësimi i punës së kryer për parandalimin dhe minimizimin e tregut informal të punës dhe mbrojtjen në punë të punëmarrësve, për periudhën 1/1/2010 deri me 30/6/2011*" dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 56, datë 02/05/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 347/5, datë 02/05/2012 dërguar ***Zj. Vikrita Çuto Drejtore e Drejtorisë së Pergjithshme të ISHP Tiranë,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të rivlerësohen, analizohen dhe rivendosen në afat, nga ana e institucionit detyrat e parealizuara dhe ato në proces, duke programuar masa afatshkurtra për realizimin e tyre, në veçanti ndjekja dhe arkëtimi i dëmit ekonomik në vlerën 187,090 lekë, nga 4 ish punonjës të ISHP-së.

Menjëherë

2. Nga Drejtoritë Rajonale të ISHP-së, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në juridiksionin e tyre, sipas veprimtarisë që kryejnë, të bëhet rakordimi i të dhënave për subjektet aktive me Drejtoritë Rajonale të Tatim-Taksave.

Menjëherë

3. Të bëhen ndryshimet e Aktmarrëveshjes së lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për parandalimin dhe minimizimin e tregut informal të punës, duke përcaktuar me korrektesë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë në zbatim të dispozitave ligjore, në kuadër të programeve të kontrollit të përbashkëta.

Menjëherë

4. Të ndiqet nga Drejtoritë Rajonale përfshirja në listëpagesat përkatëse të punëmarrësve ilegal, konstatuar gjatë inspektimeve të ushtruara në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Tatim-Taksave dhe ky tregues të shërbejë për të llogaritur efektivitetin e punës së çdo inspektori në vlerësimin vjetor.

Menjëherë

5. Të hartohen programe konkrete bashkëpunimi nga Drejtoria e Përgjithshme e ISHP-së dhe Drejtoritë Rajonale, për zbatimin e aktmarrëveshjeve përkatëse dhe

forcimin e bashkëpunimit me strukturat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vazhdimësi

6. Hartimi i programeve vjetore dhe zbatimi i buxhetit nga Drejtoria e Përgjithshme e ISHP-së, të bazohet në argumentet ekonomike, politikat dhe objektivat sektoriale, në kuadër të programit të integruar të Ministrisë, duke pasqyruar drejtimin e kryerjes së shpenzimeve, kostot faktike të çdo produkti deri në drejtoritë rajonale, duke rritur treguesit e efektivitetit.

Në vazhdimësi

7. Të kontabilizohen gjobat e vendosura në secilën Drejtori Rajonale, pas kalimit të gjithë proceseve të apelimit, mos kontabilizimi i tyre krijon premisa për keqadministrim.

Në vazhdimësi

8. Nga Drejtoria e Përgjithshme e ISHP-së dhe Drejtoritë Rajonale, të dalin urdhërat për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe të përfshihen në inventar të gjithë transferimet e AQT-ve nga entet shtetërore, procedurat e regjistrimit të pasurisë së palujtshme në Zyrat e Regjistrimit Pasurive të Palujtshme, deri në marrjen e certifikatave të pronësisë për sipërfaqet e ndërtimit së bashku me truallin, sipas planimetrive dhe gent-planeve, duke sistemuar veprimet përkatëse.

Brenda 6/mujorit 2012

9. Të sistemohen veprimet kontabile në bilancin e konsoliduar të ISHP-së të vitit 2011, nëpërmjet saktësimit të vlerës së llogarive 435 dhe 436 "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët", përkatësisht në vlerat 107,032 lekë dhe 14,852 lekë, që përfaqësojnë "Sigurimet shoqërore" dhe "Sigurimet Shëndetësore", duke bërë shpjegimin pse ndodhen në aktivet e bilancit.

Brenda 6/mujorit 2012

10. Të sistemohet në bilancin e konsoliduar të ISHP-së të vitit 2011 zëri "Ndërtime dhe konstruksione", duke përfshirë vlerën e ndërtesës para rikonstruksionit, plotësimin me dokumentacionet përkatëse në zbatim të urdhërit të Ministrit të MPÇSSHB, më pas t'i shtohej vlera e kësaj ndërtese, me kalimin e këtij objekti. Kalimi në zërin e mësipërm duhet të bëhet pas kalimit të ndërtesës në pronësi të ISHP-së.

Brenda 6/mujorit 2012

11. Të rakordohen treguesit për gjobat vjetore të vendosura në subjektet e inspektuara gjatë vitit 2010-2011, duke shqyrtuar rregullaritetin dhe nivelin e arkëtimit të tyre për çdo Drejtori Rajonale të ISHP-së. Nga Inspektoria e Përgjithshme, të nxirret përgjegjësia dhe të merren masat disiplinore, për Drejtorët Rajonal dhe inspektorët, që nuk kanë ndjekur arkëtimin e tyre.

Menjëherë

12. Të programohet kryerja e misioneve të auditimeve të plota në gjithë njësitë e vartësisë direkte, bazuar në analizën e rrisqeve dhe duke korigjuar tendencën për realizimin e planit të auditimit vetëm me auditime tematike, pasi është vërejtur një shmangie nga roli i auditimit. Kështu, për vitin 2010 auditimet tematike dhe mbikëqyrjet zënë 54% të totalit të angazhimeve gjithsej dhe për 6/mujorin e parë të vitit 2011, auditimet e plota janë realizuar në masën 50% të planifikimit.

Menjëherë

13. Të hartohet Regjistri i Auditimeve për vitin 2012, sipas kërkesave të Manualit të Auditimit Publik.

Menjëherë

14. Të ndiqet në vijueshmëri zbatimi i rekomandimeve vjetore nga struktura e auditimit, pasi konstatohet se kjo njësi nuk ka një plan të veçantë tematik të aprovuar për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për periudhën objekt kontrolli, siç përcaktohet në pikën nr. 6, Seksioni V, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, (miratuar me VKM nr. 345, datë 1/6/2004) dhe nga Kreu III, 3.2.1 i Manualit të Auditimit të Brendshëm (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29/9/2010).

Brenda Korrikut 2012

15. Të hartohet nga Sektori i Auditimit të ISHP, manuali me veçoritë specifike për auditimin e sistemit, detyrim ky që rrjedh nga neni 18/1 i ligjit nr. 9720, datë 23/4/2007 i ndryshuar dhe pika 2 e Urdhrit nr. 69, datë 29/9/2010 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të brendshëm të sektorit publik", duke përfshirë teknikat e kryerjes së auditimit, ripunimin e normave të veçanta të auditimit sipas fushave konkrete, dhe ky manual të miratohet nga Ministri i Financave.

Menjëherë

16. Të merren të gjitha masat nga DAB dhe NJQHAB për programimin e trajnimeve të detyruara për audituesit mbi Manualin e ri, procesin e formimit profesional dhe edukimin e përditësuar, pasi vërejmë se gjatë vitit 2010 nuk janë

kryer trajnime të detyrueshme, që sipas normave të Manualit të Audtimit janë 50 orë në vit. Këto trajnime të detyrueshme të bazohen në nevojat e audituesve, detyrim ky sipas nenit 20 të Ligjit nr. 9720, ku nënvizohet se *"Të gjithë audituesit në detyrë, ..., i nënshtrohen edukimit të përditësuar, trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm..."*.

Vazhdimisht

17. Të përgatiten dhe dërgohen përfundimet e misioneve të auditimit, pasi janë konstatuar vonesa dhe nga 6 misione të kryera deri në fund të 6-mujorit të parë, ishin derguar konkluzionet vetëm për 2 objekte, gjë që duhet të tërheqë vëmendjen e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në respektimin e afateve proceduriale të auditimit, me qëllim që ai të ketë efekt të dobishëm parandalues në kohë.

Menjëherë

18. Të dorëzohen me procesverbal në arkivën e institucionit të gjitha dosjet të auditimit të objekteve, për vitet 2010 dhe 2011, duke inventarizuar çdo informacion përbërës të tyre.

Menjëherë

19. Të dorëzohet me procesverbal në arkivën e institucionit dosja e tenderit "Rikonstruksion i ndërtesës së ISHP".

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Zyhra Kepi Përgjegjëse Grupi, Pranvera Doçi, Qeram Cibaku dhe Raimond Koçi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT